

Nr. Prot 451/3
dt 21/11/2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 3 Datë 15/11/2011

Per

miratimin e tarifave administrative per formularet e aplikimit dhe te lejeve per shfrytezimin e rezervave ujore.

Në mbështetje të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore" dhe të paragrafit II, pika 4. të vendimit Nr. 3, datë 19.07.2002 të K KU "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Sekretariatit Teknik të K KU, Këshillavë të Baseneve Ujëmbledhëse dhe Agjencive të Ujit",

Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin e tarifave administrative te formularve te aplikimit dhe te lejeve per shfrytezimin e rezervave ujore si me poshte.

- | | |
|--|-------------------|
| 1-Formulare aplikimi per perdorim te rezerves ujore (imbotilim, prodhim energjie, teknologji, peshkim, inerte lumore etj). | 15.000 lek |
| 2-Formulare aplikimi per perdorimin e rezerves ujore per pus-cpime. | 5.000 lek |
| 3-Leje per perdorimin e rezervave ujore per perdorimin e ujit (teknologji dhe peshkim) | 25.000 lek |
| 4-Leje per perdorimin e rezervave ujore per perdorimin e ujit | |

(imbotilim, prodhim energjie, pus-cpim dhe inerte lumore).

100.000 lek


5-Rinovim leje per perdorimin e rezervave ujore per perdorimin e ujit
(imbotilim, prodhim energjie, teknologji, peshkim, inerte lumore).

50.000 lek

6-Vendimi Nr 15 date 24.01.2007 i KBU Seman per "Miratim i tarifave per terheqjen e formulareve te aplikimit" shfuqizohet

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËRGJEGJËSI AUB
SEMAN
Saimir HOXHAJ**



**KRYETARI I KBU
SEMAN
Bujar HASAJ**

